



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME

Komiteti për Komunitete

Nr.01-060/01-10071/24 datë: 22.04.2024



Npi – 01/159 datë: 26.04.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 26.04.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 26.04.2024 (e premte) në ora 13:30 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, znj.Shkurte Behluli, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Nga zyra për informim znj.Vlora Hyseni.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.03.2024,
2. Draft-Plani i veprimit për komunitete Rom dhe Ashkali 2024-2026 (pas diskutimit publik),
3. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës, por propozoj që në rendin e ditës të futet edhe një pikë shtesë “Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit Nr.Npi-01/75 për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024”.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Edhe unë mendoj se është mirë me e futë edhe këtë pikë shtesë në rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht e miratoi renin e ditës me pikën shtesë si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.03.2024,
2. Draft-Plani i veprimit për komunitete Rom dhe Ashkali 2024-2026 (pas diskutimit publik),
3. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit Npi-01/75 për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në 2024”.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.03.2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Konstatoj kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 27.03.2024.**

Pika 2

Draft-Plani i veprimit për komunitete Rom dhe Ashkali 2024-2026 (pas diskutimit publik
Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Para se ta hapi diskutimin për këtë pikë, dua të them se ne si Komitet muajin e kaluar kemi rekomanduar që të mbajmë diskutim publik për Draft-Planin lokal të veprimit për komunitetet Rom dhe Ashkali për periudhën 2024-2026 me rekomandimin që procesi i diskutimit publik të organizohet në Shtime, Gjyrkovc dhe Vojnovc, mirëpo në procesin e diskutimit publik nuk ka ardhur askush. Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Pse ne nuk kemi qenë pjesë e këtyre diskutimeve, megjithatë unë po e shoh që rekomandimet tona nuk janë ardhur në zyrën e Informimit. Sipas rekomandimit është dashur të shkohet edhe në Gjyrkovc kështu që faji mbetet te ekzekutivi. Unë nuk e di se çka është diskutuar.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Dy vite na kan ikur kot pa draft-planin e veprimit. Unë mendoj se shumë më mirë është që ti rekomandojmë Kuvendit për votim dhe ta kemi një plan, se sa të mos kemi fare.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Planit Lokal të Veprimit për komunitetet Rom dhe Ashkali për periudhën 2024-2026.**

Pika 3

Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit Npi-01/75 për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në 2024"

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; E kemi pas një Buxhet jo shumë të definuar, kështu që një rekomandim i Komitetit për Komunitete duhet me ju shkuar financave për sa i përket festave zyrtare për komunitetin Rom dhe Asghkali. Tani meqenëse jemi duke diskutuar për bartjen e të hyrave unë mendoj se kemi mundësi me rekomandu për Kuvend një shumë të caktuar.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë kisha rekomanduar që një shumë e caktuar e mjeteve nga të hyrat me shkuar për shkolla.


Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 14:00h.

Procesmbajtës
Valmira Hoxha



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

